



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 shkurt 2019
Nr. Ref.:RK 1319/19

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI134/18

Parashtrues

Bajram Santuri

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, P. nr. 375/2013, të 5 qershorit 2013,
Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000,
të 25 shtatorit 2012 dhe
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 46/2005, të 28 dhjetorit 2006

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Bajram Santuri (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës ka specifikuar se konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, P. nr. 375/2013, të 5 qershorit 2013, Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. 46/2005, të 28 dhjetorit 2006.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi në kërkesën e tij nuk saktëson se cila e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) i është shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 gusht 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
6. Më 29 gusht 2018, Gjykata pranoi dokumente shtesë nga parashtruesi i kërkesës.
7. Më 17 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërzhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 27 shtator 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ai që të plotësojë dhe dorëzojë në Gjykatë formularin e kërkesës, të specifikojë se cilin akt apo vendim të autoritetit publik e konteston dhe të saktësojë se cila e drejtë e garantuar me Kushtetutë i është shkelur.
9. Më 15 tetor 2018, Gjykata pranoi 4 (katër) formularë të ndryshëm të kërkesës të plotësuar dhe nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës. Në 5 (pesë) zarfe të ndryshme, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte bashkëngjitur dokumente dhe materiale të ndryshme, që nuk ndërlidhen me kërkesën për informata shtesë të Gjykatës, të 27 shtatorit 2018.
10. Më 16 janar 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 15 dhjetor 2009, parashtruesi për herë të parë kishte parashtruar kërkesë në Gjykatë (kërkesa nr. KI63/09, Aktvendimi për papranueshmëri i 6 korrikut 2011), me të cilën kishte kërkuar vlerësimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 46/2005 (C. nr. 99/07), të 28 dhjetorit 2006 dhe të disa vendimeve tjera gjyqësore. Gjykata kishte shpallur kërkesën e parashtruesit të papranueshme.
12. Më 1 prill 2014, parashtruesi për herë të dytë kishte parashtruar kërkesë në Gjykatë (kërkesa nr. KI65/14, Aktvendim për papranueshmëri i 1 korrikut 2014), me të cilën kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012 dhe të disa vendimeve tjera gjyqësore. Gjykata kishte shpallur kërkesën e parashtruesit të papranueshme.
13. Më 28 gusht 2018, Gjykata pranoi kërkesën e parashtruesit, i cili parashtroi kërkesë në Gjykatë për herë të tretë.
14. Në kërkesën e tij, të pranuar nga Gjykata më 28 gusht 2018 dhe në dokumentet shtesë të 29 gushtit 2018, parashtruesi i kërkesës nuk dorëzoi formular të plotësuar të kërkesës, nuk specifikoi se cilat vendime të autoriteteve publike i konteston, si dhe nuk saktësoi se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur. Në dokumentacionin që parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar në Gjykatë kishte shkresa, ekstrakte të vendimeve të ndryshme, kryesisht të paplota dhe materiale të ndryshme, për të cilat parashtruesi nuk kishte specifikuar fare nëse ato i konteston dhe cilat ishin pretendimet dhe arsyetimet e tij në lidhje me tërë dokumentacionin e dorëzuar.
15. Më 15 tetor 2018, si rezultat i kërkesës së Gjykatës për plotësimin e kërkesës së tij, parashtruesi i kërkesës dorëzoi 4 (katër) formularë të ndryshëm të kërkesës, si dhe materiale dhe dokumente të ndryshme.
16. Në shkresat e dosjes, të pranuar më 15 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës po ashtu kishte bashkëngjitur edhe një Aktvendim të Gjykatës së Apelit, Ac. Nr. 3295/14, të 2 korrikut 2018, me të cilin ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, T. Nr. 235/02, të 11 korrikut 2014 ishte aprovuar si e themeltë.
17. Në formularin e parë të kërkesës, parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike konteston Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012. Parashtruesi këtë aktvendim po ashtu e kishte kontestuar në kërkesën e tij KI65/14, të vendosur nga Gjykata më 1 korrik 2014.
18. Në formularin e tretë të kërkesës, parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike sërish konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 46/2005, të 28 dhjetorit 2006. Parashtruesi këtë aktgjykim e kishte kontestuar në kërkesën e tij KI63/09, të vendosur nga Gjykata më 6 korrik 2011. Në këtë formular, parashtruesi i kërkesës po ashtu kishte cekur edhe një shkresë njoftuese dhe sqaruese të Departamentit Ligjor të Këshillit Gjyqësor nr. 149/2018 të 17 shtatorit 2018.

19. Në formularin e dytë dhe të katërt të kërkesës, parashtruesi i kërkesës, konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, P. nr. 375/2013, të 5 qershorit 2013. Përkitazi me këtë aktvendim, Gjykata e Apelit e kishte refuzuar ankesën e parashtruesit si paditës privat kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, P. nr. 350/2013, të 15 prillit 2013. Mirëpo, në lidhje me këtë vendim, parashtruesi nuk ofroi sqarime dhe informata lidhur me procedurën e ndjekur gjyqësore, arsyetimi dhe pretendimet e tij ishin të paqarta dhe konfuze, si dhe nuk saktësoi se cilat të drejta të garantuar me Kushtetutë i ishin cenuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi, në 4 (katër) formularët e kërkesave ka specifikuar se konteston:
- (i) Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. 46/2005, të 28 dhjetorit 2006, të cilat respektivisht i kishte kontestuar edhe në kërkesat e tij të mëhershme, të vendosura nga Gjykata (KI65/14 dhe KI63/09); dhe
 - (ii) Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, P. nr. 375/2013, të 5 qershorit 2013.
21. Në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, P. nr. 375/2013, të 5 qershorit 2013, parashtruesi i kërkesës përmend çështje të trashëgimisë familjare, zvarritje të procedurave, mirëpo nuk ofroi përmbledhje të qarta të fakteve lidhur me procedurat para gjykatave. Arsyetimet e ofruara nga parashtruesi janë të paqarta, si dhe ai nuk kishte saktësuar se cilat të drejta të mbrojtura me Kushtetutë i ishin shkelur me këtë aktvendim.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Gjykata, po ashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

25. Në rastet kur kërkesa është e pakompletuar dhe nuk i përmbush kriteret kushtetuese dhe ligjore të pranueshmërisë, Ligji dhe Rregullorja e punës përcaktojnë procedurën që duhet ndjekur nga Gjykata në mënyrë që parashtruesit t'i jepet mundësi për të kompletuar dhe plotësuar kërkesën e tij.
26. Rrjedhimisht, Gjykata me shkresën e 27 shtatorit 2018 kishte kërkuar nga parashtruesi që të plotësojë dhe të dorëzojë në Gjykatë formularin e kërkesës, të specifikojë dhe qartësojë se cilin akt apo vendim të autoritet publik e konteston dhe të saktësojë se cila e drejtë e garantuar me Kushtetutë i është shkelur.
27. Parashtruesi i kërkesës, në formularët e kërkesave të dorëzuara më 15 tetor 2018, ka specifikuar se konteston vendimet e gjykatave të rregullta si në vijim:
 - (i) Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. 46/2005, të 28 dhjetorit 2006 dhe Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012, të cilat i kishte kontestuar edhe në kërkesat e tij të mëhershme në Gjykatë, respektivisht kërkesat KI65/14 dhe KI63/09; dhe
 - (ii) Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, P. nr. 375/2013, të 5 qershorit 2013, për të cilin nuk saktëson se cilat të drejta të mbrojtura me Kushtetutë i janë shkelur dhe po ashtu nuk ka plotësuar dhe qartësuar kërkesën e tij me informata konkrete përkitazi me procedurat gjyqësore.
28. Në këtë aspekt, dhe duke marrë parasysh atë që u cek më lartë, Gjykata në bazë të Rregullores së saj të punës, mund të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.
29. Gjykata i referohet rregullit 35 të Rregullores, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35

[Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës]

“35 (5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata,[...]”.

(i) Në lidhje me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012 dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. 46/2005, të 28 dhjetorit 2006

30. Gjykata rikujton se, parashtruesi i kërkesës aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012, e kishte kontestuar edhe në kërkesën e tij të mëhershme KI65/14, të vendosur nga Gjykata më 1 korrik 2014.
31. Gjykata, po ashtu, rikujton se parashtruesi i kërkesës aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, Rev. 46/2005, të 28 dhjetorit 2006, e kishte kontestuar në kërkesën e tij KI63/09, të vendosur nga Gjykata më 6 korrik 2011.

32. Prandaj, Gjykata rithekson se ajo tashmë ka gjykuar rastet KI65/14 dhe KI63/09, dhe në kërkesën e tanishme, parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ndonjë fakt apo provë të re.
33. Rrjedhimisht, sipas rregullit 35 (5) të Rregullores së punës kërkesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. 46/2005, të 28 dhjetorit 2006 dhe Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012, është përsëritje e kërkesave të mëparshme të vendosura nga Gjykata.

(ii) Në lidhje me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, P. nr. 375/2013, të 5 qershorit 2013

34. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në formularin e dytë dhe të katërt, të pranuar nga Gjykata më 15 tetor 2018, kishte specifikuar se konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, P. nr. 375/2013, të 5 qershorit 2013.
35. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm specifikon se e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, përmend çështje të trashëgimisë familjare dhe zvarritje të procedurave, por nuk ofron përmbledhje të qarta të fakteve lidhur me procedurat para gjykatave, përkatësisht nuk ofron informacion procedural dhe substantiv. Arsyeimi i parashtruesit të kërkesës lidhur me faktet dhe procedurat e ndjekura është i paqartë, dhe për më tepër ai nuk saktëson se cilat janë pretendimet e tij konkrete lidhur me këtë aktvendim ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.
36. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i deklaron këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesit të kërkesës. (Shih rastin KI48/17, *Sladana Radojković-Marinković*, Gjykata Kushtetuese, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 21).
37. Prandaj, Gjykata në bazë të nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 35 (5) të Rregullores së punës konstaton se kërkesa e parashtruesit, përmes të cilës ka kontestuar Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, P. nr. 375/2013, të 5 qershorit 2013 është e paplotë dhe e paqartë.

Përfundim

38. Si përmbledhje, Gjykata në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës përfundon se kërkesa e parashtruesit duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër për arsye se:
- (i) Përkitazi me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. 46/2005, të 28 dhjetorit 2006, kërkesa është përsëritje e kërkesave të mëparshme të vendosura nga Gjykata; dhe

- (ii) Përkitazi me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, P. nr. 375/2013, të 5 qershorit 2013, kërkesa është e paplotë dhe e paqartë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 janar 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Balram Ljatifi




Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
